

POETËT NGA GJAKOVA - NË SUEDISHT

POETERNA FRÅN GJAKOVA - PÅ SVENSKA

ZGJODHI

I URVAL AV

S H E F I O S E K U

PËRKTHEU

ÖVERSÄTTNING AV

ULMAR KVIKU

HAJDIN ABAZI

Libri u botua me ndihmën e ABF-it, në Treleborg, Suedi

Boken är utgiven med hjälp av ABF, i Trelleborg, Suedi

BOTIM I REVISTËS "DRITA", NË TRELEBORG, SUEDI

UTGIVEN AV TIDSKRIFTEN DRITA, I TRELLEBORG, SVERIGE

•

POETËT NGA GJAKOVA - NË SUEDISHT

POETERNA FRÅN GJAKOVA - PÅ SVENSKA

ZGJODHI

I URVAL AV

S H E F K I O S E K U

KORREKTORË

për poezitë në gjuhën shqipe si dhe tekstet tjera

KORREKTURLÄSARE, för albanska dikter och andra texter

Shefki Oseku

Ulmar Kvik

Agim Mazari

Kompjuterizimi

Dataansvarig

Frashër Oseku

Libri u botua me ndihmën e ABF-it, në Treleborg, Suedi

Boken är tryckt med hjälp av ABF, i Trelleborg, Sverige

U dorëzua në shtyp në janar të vitit 2010

Till tryckning januari 2010

BOTIM I REVISTËS "DRITA" NË TRELEBORG, SUEDI

UTGIVEN AV TIDSKRIFTEN DRITA I TRELLEBORG, SVERIGE

TIRAZHI 1000 copë

UPPLAGA 1000 ex.

Për ndihmën e pakursyer, e falenderoj për zemërsisht:

Lars-Olof Obergun

dhe

kryesinë e ABF-it

të Trelleborgut

Kryeredaktori i Revistës "Drita", në Trelleborg, Suedi

S H E F K I O S E K U

Ett stort tack för all hjälp till:

Lars-Olof Åberg

och

styrelsen i ABF

Trelleborg, Sverige

S H E F K I O S E K U

Chefredaktör för den albanska Tidskriften

Drita i Trelleborg, Sverige

BESIM BOKSHI

IM ET

Më doli gjumi. Lampa e ndezur!
Ti i mbështetur po rrije në skaj
dhe shikoje dritën -
ndoshta dhe fluturën që sillej rreth saj

Veshët ushtonin në qetësinë e natës...

Flutura u dogj...

Në sytë e tu dallova lot
e thashë: ç'brenga Baba ka?!
Sot mendoj:
Babë, u dogje pa lëshuar zë!

BESIM BOKSHI

MIN FAR

Jag vaknade. Lampan var tänd!
Du satt där i hörnet
och tittade på ljuset -
och kanske också på fjärilen som flög kring det

Öronen bedövades av nattens tystnad...

Fjärilen förbrändes...

I dina ögonen såg jag tårar
och sa: vad är det som bekymrar dig, pappa?
Idag tänker jag:
Far, du förbrändes helt i tysthet!

NË PRITJE

Kam pritur - si shkëmbi,
si ylli skaj horizontit - në pikëllim,
vite me radhë...

Larg jam,
aty ku puthen jeta dhe vdekja -
aty i përtyt ditët e mia të gastarta...

Kur të vijë,
ndoshta do të më gjejë të mplakur
e s'do të mund të qesh si flladi i pranverës

Të vdes - nga gëzimi,
do të mundem!

I VÄNTAN

Jag har väntat - som en klippa,
som stjärnan invid horisonten - i sorg,
år efter år...

Jag är långt borta,
där livet och döden berör varann -
Där jag tuggar mina glasklara dagar...

När du kommer,
hittar du mig kanske helt åldrad
och jag kommer inte att kunna skratta likt vårens vind

Men jag kommer att kunna
dö - av glädje!

NATA KRIMINALE

Sonte zbriti plakë e lodhur,
dhe thith gazin, vajin, gjëmimet e ditës
thellë, thellë ku kërret terri.
Si nata vetë, bota u bë memece.

E ndjeva kur jehoi vonë
në gjirin e saj prej korbi,
kur jehoi shurdhët si vdekja një ofshamë

Dikush humbi një yll,
një shok në natën memece!

E pashë kur ia thithi sytë
thellë ku kërret terri -
kur ai thithi lehtë si gjakun e tij

Dije!
Sonte u shuan edhe dy xixa
këtu poshtë, në fund të natës
Sonte vdiq një njeri shurdhazi si nata!

DEN BROTTSLIGA NATTEN

Ikväll steg hon ner likt den trötta, gamla kvinnan,
och sög glädje, sorg, dagens buller
djupt, djupt in i mörkret.
Likt natten blev världen stum.

Jag hörde när det genljöd sent
i hennes korpsvarta bröst,
när det dovt som döden hördes en suck

Någon förlorade en stjärna,
en vän i den stumma natten!

Jag såg när hans ögon sögs upp
djupt in i mörkret -
när de sögs upp lika lätt som hans blod

Du skall veta, du!
I kväll slocknade två gnistor till
Här nere, vid nattens slut
I kväll dog en människa stumt som natten!

XAJË NURA

PO TË ISHA POET

dashurisë do t' i bëja skalitje
me aromë purpure
qiellin blu do ta shkruaja
me diellyje
damarët e njeriut vertikal
do t' i mbushja me balsam dheu
në kopsht do të shartoja
zogj e lule për shqisa
në bebëza do të bëja
qendisma me agime brezash
ku ta di se çka tjetër do të bëja
të isha poet jashtë ëndrrës

XAJË NURA

OM JAG VORE POET

skulle jag krydda kärleken
med en arom av purpur
på den blå himlen skulle jag skriva
med solstjärnor
ådrorna på den vertikala människan
skulle fyllas i med jordens balsam
i trädgården skulle jag ympa
fåglar och blommor för sinnena
på ögonens pupiller skulle jag
brodera släktledens gryningar
och vem vet hur mycket annat jag skulle kunna göra
om jag vore poet utanför drömmen

VETËM FAJI

mjerisht në errësirë ballkanike
derivat i Evrobotës anemike
verb frymëzimi i eposit pagan
emblemë me hiroglife province
zoti sheh po s`ka ç`bën
zari humb e letra djeg
daullet trumbetojnë

ENDAST SKULDEN

I Balkans dunkel -
en produkt av den anemiska Eurovärlden
ett ord inspirerat av det hedniska eposet
ett emblem med provinsens hieroglyfer -
ser Gud allt men kan tyvärr inget göra
tärningen slår fel och papperet bränns
trummornas dunkande breder ut sig

KËNDEJ GARDHI

në fontanë mozaiqe të nemitura
fontana loton -bën kujën prore
mbi të bilbili vetmitar
shpalos membranë të ferkut
në kupa na ligjëron e bekuara
vajton dikë diçka në të gdhirë
kuptojmë këngën magjepëse
nga lulet mbledh aromat
shpirtit i bën nektar e balsam
në horizont kalashnikovi bën qepjen e tmerreve
me dritën e vrarë dhe zëbilbilin bonjak

PÅ DENNA SIDAN STAKETET

i fontänen förstummade mosaiker
fontänen faller tårar – gråter ständigt
över den låter en ensam näktergal
sina stämband dallra
I koppen läser vi en välsignad utsago
någon sörjer något i gryningen
vi förstår den förtrollande sången
från blommorna samlas dofterna
och blir till nektar och balsam för själen
vid horisonten hackar en kalasjnikov fram skräcken
I det slocknade ljuset och i näktergalens förtvivlade röst

AGIM GJAKOVA

TINËZARJA NATË

Nata po fsheh rrobet e veta të zeza
nëpër gropa të ndyta
në gremina të thella
po zhduket nëpër tokën e çarë, të gropuar
tinzarja natë, dhelpira natë
që më la pa gjumë këtë kohë kaq të gjatë.

Kur hëna iku, perendoj dhe nata u shua
ende më ziente e vrullshme një dëshirë...
mëngjesi kishte gdhirë i ngrirë.

AGIM GJAKOVA

DEN LISTIGA NATTEN

Natten gömmer sina svarta kläder
inne i smutsiga hål
djupt nere i avgrunden
försvinner genom sprucken, gropig jord
den listiga natten, den rävsluga natten
som lämnade mig utan sömn så lång tid.

När månen gick ned och släcktes och natten försvann
sjöd alltjämt en längtan hett inom mig
men morgonen grydde stel av köld.

IM BIR

Merr ç` të duash nga gjaku im
nga dashuria ime merr ç` të duash
të tjerat ngelen
dhe pa ngulmimin tim
dhe pa vullnetin tënd.

MIN SON

Ta vad du vill från mitt blod
från min kärlek ta allt du vill
allt övrigt står kvar
även utan min ihärdighet
även utan din vilja.

PARANDJENJA

Zymtia ka nisë të stërpshtjellohet llugave
të gatuajë termetin

më ndjeni o ju të verbër e ju të shurdhër
pse e parashoh nuk është faji im

kë të dua kë të urrej
në gjirin e njerëzve të mi!

FÖRANING

Grymheten har letat sig in i buskagen,
för att laga till en jordbävning

förlåt, ni som är blinda och ni som är döva
att jag anar men det är inte mitt fel

vem skall jag älska, vem skall jag hata
bland mina medmänniskor?

DIN MEHMETI

POETËT ZGJOHEN

Kur heshtja mbulon çdo gjë
Kur të gjithë flenë
Zgjohen poetët
Për t'u djegur nëpër vargje
Ata ia shtrydhnin gjakun e keq mendimit
Shpirti i tyre shesh betejash
Nga temperatura e fjalëve
Vdesin ngadalë pa klithma.

DIN MEHMETI

POETERNA VAKNAR

När tystnaden omfattar allt
När alla sover
vaknar poeterna
för att brännas i dikten
De åderlåter tankarna på det onda blodet,
deras själar – slagfält
Av ordens temperatur
dör de långsamt, utan klagan.

YJET E DJEGUR

Mbi tokë reshje mbeturinash
Yjesh të djegur

Krejt çka mund të bëjë
është heshtje e thellë
para zjarrit

Ky shikim pa cak
në qiellin e thinjur

Krejt çka mund të bëjë
është të ëndërroj gjatë
që të mos vdes përgjithmonë.

DE BRÄNDA STJÄRNORNA

Över jorden en skur av avfall
från brända stjärnor

Allt vad jag kan göra
Är att hålla en djup tystnad
före branden

Denna blick utan mål
mot den gråa himlen

Allt vad jag kan göra
är att drömma en lång tid
för att inte dö för evigt.

LIQENI

Liqeni u nxi,
u çmend

Barka ime mbahu!

Këtej i ke shkëmbinjtë
e eshtrave
andej ëndërrat e pavdekshme

Barka ime mbahu!

SJÖN

**Sjön svartnade,
blev galen**

Rid ut stormen, min båt!

**På den här sidan finns undervattensrev
av skelett
på den andra sidan odödliga drömmar**

Rid ut stormen, min båt!

ALI PODRIMJA

KOSOVA

Zgjohu, Kosovë! Zgjohu, nëna ime e dashur,
balli dhe emri im i shkelur –
zgjohu, oj! A po e ndien vajin tim?
A po sheh si t'i kam ngulur sytë
mu në zemër, mu në shpirtë,
si t'i kam hedhur duart rreth belit
për të përqaftuar, unë - ashti yt?
Zgjohu, Kosovë!
Nga degët e mia të thyera kush po bahet,
këtë vatër kush po e le?
Ç'janë këto gjurmë gjaku që po shtohen?
nëpër fytyrën tënde,
këto varre e murrana që po sillen vërdallë
rreth shtëpisë sime?..
Zgjohu, Kosovë! Zgjohu, nëna ime e dashur,
Balli dhe emri im i shkelur –
zgjohu, Kosovë!
Sonte vetëm mbeta e –
në derë t'oborrit askush më s'po më troket,
askush më, thua vdekur jam e harruar
në këto troje e suka gjaku;
thua më është shkimbur hisja
e mbyllur dera e konakut..
Zgjohu, Kosovë! – flakë e hershme e ashtit tim të pëlçitur,
Bota në ty le të kallet!

ALI PODRIMJA

KOSOVA

Vakna, Kosova! Vakna, min kära mor,
min förtrampade panna och mitt förtrampade namn—
Vakna, du! Hör du inte min gråt?

Ser du hur jag borrar min blick
in i ditt hjärta, in i din själ,
hur jag har gripit tag om din midja med mina händer
för att krama dig, jag – ett ben ur din kropp?

Vakna, Kosova!

Från mina brutna grenar vem går ifrån,
Vem är det som lämnar detta hem?
Vad är dessa blodspår som alltmer syns
i ditt ansikte,
dessa gravar och stenhögar som virvlar
runt mitt hus? ...

Vakna, Kosova! Vakna, min kära mor,
min förtrampade panna och mitt förtrampade namn—
Vakna, Kosova!

I kväll blev jag ensam –
Det är ingen som knackar på min dörr
Som om jag hade dött och blivit glömd
I det här blodiga landet och på dessa blodiga kullar;
Som om släktet utplånats
Och porten till mitt hus stängd för alltid...

Vakna, Kosova! - du, den gamla lågan ur mina knakande knotor
Låt världen brinna i dig!

RANË PERËNDITË

Para shtëpisë
më vratë –
Unë qesha.

Në degën më të lartë të plepit tim
më varët –
Unë qesha

Në gjinjtë e gruas sime lehonë
pështytë –
dhe ranë perënditë

dhe perënditë
ranë
pas kokës sime

GUDARNA FÖLL

Framför mitt hus
Mördade ni mig -
Jag skrattade.

På min poppels högsta gren
hängde ni mig -
Jag skrattade

På min nyförlösta frus bröst
Spottade ni -
och gudarna föll

och gudarna
föll
efter mitt huvud

KALI I TROJËS

kthehu në vargun e Homerit
kthehu atje prej nga erdhe
koha jote s'është kjo kthehu
liroji njerëzit prej vetevetes
e hijeve liroji prej maskave
e ikjeve liroji prej pagjumësisë
e heshtjeve liroji prej etheve
e shirave koha jote s'është kjo
kthehu në vargun e Homerit
Troja e ra e marsejezën
kahmot s'e këndojnë njerëzit

HÄSTEN FRÅN TROJA

återvänd till Homeros vers
återvänd dit du kom ifrån
det är inte din tid, vänd åter
befria människorna från sig själva
och skuggorna från deras masker
och befria avskeden från sömnlösheten
och tystnaden från febern
och regnen. Detta är inte din tid
återvänd till Homeros vers
Troja har fallit och Marseljäsen
var det längesedan någon sjöng

KADRUSH RADOGOSHI

SHOKËT E MI

U lindën
në pika të ndryshme të globit
Platoni i përzuri nga shteti ideal
i mallkoi...
Asnjë shtet nuk iu dha azil
ata krijuan shtetin e tyre...
Aty filluan ta krijojnë portretin e botës
me pika klorofili e polen lulesh
me krah dallëndyshesh e fluturime fluturash...
Në shtetin e tyre ideal
mbetën gjithmonë të rinj
dashnorë të përjetshëm mbetën
shokët e mi...

KADRUSH RADOGOSHI

MINA KAMRATER

De föddes
på olika platser på jorden
Platon förvisade dem från den ideala staten
och förbannade dem...
Ingen stat gav dem asyl
de skapade sin egen stat...
De började skapa bilden av världen
med droppar av klorofyll och pollen från blommor
med svalans vingar och fjärilars flykt...
I sin ideala stat
förblev de alltid unga
som odödliga älskare
mina kamrater...

AKUZIM PUBLIK

Akuzohem publikisht akuzohem
pse në klasën e parë kam vizatuar një rrugë pa fund
me shtëpi plot dritare dashurie
mbi të një qiell e në qiell një diell...
Akuzohem publikisht akuzohem
pse me shkronjat e mësuara legalisht
lexova lirinë e ikur ilegalisht nga definicioni i vet
pse historisë ia tregova adresën e saktë të së vërtetës
para se të hyjë në muze
para se të mësohet mirë apo gabimisht në shkollë
e vërteta strukur në jetën që m'i vodhi vargjet
e strukur në vargjet që ma vodhën jetën
arenë antike e vonuar dy mijë vjet.

Akuzohem publikisht akuzohem
pse fëmijët i kam pagëzuar
me emra më të vjetër se dy mijë vjet: Brikenë, Epikad
Brikena tash ka mbushur më tepër se 2009 vjet
Epikadi ka vetëm nëntë vjet më pak
megjithatë janë të rinj, besa fëmijë
e luajnë me lodra që ua vjedhin babanë,
aty për aty, në mes të ditës apo natës...
Akuzohem publikisht akuzohem
pse besuakam në një tjetër Zot
të pagëzuar mijëra herë në emër të herezisë
herë Promete herë Galile, Xhordano Bruno e Skënderbe...

Akuzohem publikisht akuzohem
pse jetuakam në mes të Tokës e Qiellit...

OFFENTLIGT ANKLAGAD

Offentligt anklagad blev jag, anklagad
för att jag, när jag gick i första klass
tecknade en väg utan slut
med ett hus fullt av kärlekens fönster
Ovanför det en himmel och på himlen en sol

Anklagad offentligt blev jag, anklagad
för att jag med de bokstäver som jag lärt mig lagligt
läste friheten som förvisats olagligt från sin egen definition
För att jag visade historien sanningens exakta adress
Innan den fick komma in på museet
Innan den - på bra eller felaktigt sätt - fick undervisas
om i skolorna

Sanningen gömd i livet som stal mina dikter
Gömd i dikterna som stal mitt liv
En amfiteater, försenad två tusen år

Offentligt anklagad blev jag, anklagad
för att jag döpte mina barn
till de över två tusen år gamla namnen Brikena och Epikad
Brikena har nu fyllt mer än 2009 år
Epikad är bara nio år yngre
likväl är de unga, bara barn
och leker med leksaker som de stulit från pappa
här och där, mitt på dagen eller natten
Offentligt anklagad blev jag, anklagad
för att jag tror på en annan gud
Som tusentals gånger blev döpt i kätteriets namn
Än till Prometheus, än till Galilei eller Giordano Bruno
eller Skanderbeg ...

Offentligt anklagad blev jag, anklagad
för att jag lever mitt emellan jorden och himlen ...

DIALOG ME GRUAN TIME

Të vetmen hajni në jetë
e kam bërë
kur ta vodha zemrën...Ç`kuptim do të kishte jeta
pa lulishten e syve tu
pa detin e shpirtit tënd
ku zhytem e mbytem çdo ditë?!...
Ti më joshe ta harroj
gjer në fund
alfabetin e urrejtjes.
Për çdo ditë ma vret vetminë
kur hyn pa trokitur
nëpër portat e shpirtit...

SAMTAL MED MIN FRU

den enda stöld som jag
i hela mitt liv begått
var när jag stal ditt hjärta... Vilken mening skulle livet ha
utan dina ögons lustgård
utan din själs hav
där jag slukas upp och drunknar varje dag?

Du lockade mig att glömma
helt och för alltid
hatets alfabet.
Varje dag dödar du min ensamhet
när du utan att knacka kommer in
genom min själs dörrar ...

SHEFKI OSEKU

KOSOVARI I MËRGUAR

e mori kosovari valixhen
tre fëmijët e vet
dhe u nis drejt Veriut

majtas ishte gremina,
djathtas që ngrehina e Agata Kristit
prapa mynxyra e Drenasit të kësikohshëm*

sapo zbriti në tokën e Premtuar
fëmijët e gjetën kutinë e Pandorës
dhe u mrekulluan

kosovari ngeli fill i vetëm
veç me Kosovën e tij
në ëndrra

* Kjo poezi u shkrua më 1991, kur në Drenas policia serbe i detyronte shqiptarët të hanë bar !!!

SHEFKI OSEKU

KOSOVAREN I LANDSFLYKT (1)

kosovaren grep sin väska
tog sina tre barn i hand
och reste mot Norden

till vänster en avgrund
till höger Agatha Christies byggnad
bakom honom eländet i Drenas (2)

då han nedsteg på det förlovade landets jord
hittade barnen Pandoras ask
och förundrade sig

kosovaren stod där ensam
med bilden av sitt Kosova
som enda sällskap i drömmen (1991)

(1) Kosovaren är en Kosovaalban.

(2) Det år dikten skrevs - hade den serbiska polisen
i Drenas i Kosova, tvingat albanerna att äta gräs!!!

S'PASKA ZOT, AS PERËNDI

nuk paska shenjtëri
as profet madje, as Zot as Perëndi!
koka po u dhemb shkronjave
nga emrat Krisht, Muhamet, Marks,
nga fjalët hyjni, barazi, të drejta njerëzore...

mbi abetaren time të lidhur në pranga
hije po bën drapërçekani i Lenin - Stalinit
përmendorja e Lirisë së Vashingtonit
dega e ullirit në sqep të pëllumbit të OKB-së
fjala paqe e shkruar me germa të mëdha
mbi qefinin e bardhë të fisit tim
fatzi

im bir hipur mbi kullën e Dukagjinit
zëshëm po çirret, o Zot, ku je?
po bythecët me kundërmim pomade
në pallatet e akulllandit
të OSBE - së, OKB - së, BE - në
në Gjenevë, Nju York, Strasburg, Hagë...
thirrjen e tim biri
sipas pentagramave me nota londineze
e pagëzokan me nofkën
blasfemi!?

s'paska Zot, as Perëndi!

(shkruar më 1993)

DET FINNS INGEN ALLMAKT, INGEN GUD

det finns ingen helgedom
ingen profet, ingen Herre eller Gud!
alla skrivtecken har huvudvärk
av namnen Kristus, Muhammed, Marx
av orden gudom, jämlikhet, mänskliga rättigheter...

över min ABC-bok som fjättrats i bojor
faller en skugga från Lenin - Stalins hammare och skära
från Frihetsstatyn i Washington
från olivkvisten i näbben på FN - duvan
från ordet fred skrivet med stora bokstäver
från mitt plågade släktes
vita svepning

min son ropar med hög röst
från toppen av stentornet i Dukagjini: (1)
Gud, var finns du?
men de pomadadoftande torskarna
som befolkar OSSE:s, FN:s och EU:s iskalla palats
i Genève, New York, Strassbourg, Haag ...
begrundar pentagrammen i Londonfördraget (2)
och på min sons rop
klistrar de etiketten "blasfemi"

det finns ingen allmakt, ingen Gud!

(skriven 1993)

(1) Östra delen av Kosova.

(2) Fördraget efter Londonkonferensen 1912-13 innebar ett dråpslag mot den albanska nationen, som klövs mitt itu. En svag och stympad albansk stat bildades, men hela Kosova och stora albanskspråkiga områden i Montenegro och Makedonien hamnade under den sydslaviska statsmakten - senare kungariket Jugoslavien.

NJË LLOJ DRITE TJETËR

edhe një herë i lexova poezitë e mia për ty
befas më ra në sy se
për së tepërmi i përmendkam yjet, diellin, hënën, ylberin
(mbase jam frikësuar
mos, vallë, brenda vargjeve të mia po të kaplon një hije terri !?)
sonte, në këtë poezi, s'do t'i përmend këto fare
do ta gjej një lloj drite tjetër, të panjohur deri më tani
që të llamburisë mbi këto udhë të gjata rreshtash
gurë s'do të lë pa lëvizur, këtë dritë për ta gjetur
po, vallë, si do ta gjejë unë, poeti?
po më duket se rrugëdalje tjetër s'më ka mbetur
veçse n'e marrsha emrin tënd
Doruntinë

ETT ANNAT SLAGS LJUS

återigen läste jag mina dikter för dig
och plötsligt blev jag varse
att jag ideligen nämner stjärnorna, solen, månen, regnbågen
(fanns där kanske en rädsla
att en mörk skugga skulle nästla sig in i mina versrader!?)
nu i kväll ska inget av detta föras på tal
jag ska finna ett annat slags ljus, tidigare okänt
som ska ge mina versers långa stråk en vackrare glans
ingen sten ska lämnas oprövad, oförtrutet ska jag söka
för att finna detta ljus
men hur ska jag som poet finna det?
till sist inser jag att det bara finns en väg att nå dit
nämligen att som ett ljus föra fram ditt namn
Doruntina

ESAT CËRMJANI

MES ËNDRRËS E ZHGJËNDRRËS

**Në vegjëli besoja se do ta bëj botën ashtu si dua vetë:
Pa shpirtëra të shtypur, pa lyparakë, pa ushtarë...
Por, prej krejt kësaj tani, veç një ngushllëllim më ka mbetë
- Të paktën të krijoj diçka si vjershëtar.**

ESAT CĚRMJANI

MELLAN DRÖM OCH VAKA

I barndomen trodde jag att jag skulle kunna göra världen
sådan som jag ville ha den:
Utan förtryckta själar, utan tiggare, utan soldater ...
Men av allt detta, har jag nu kvar en enda tröst
- Att åtminstone skapa något som diktare.

VJESHTA

Në ballkonin e spitalit qëdronte djali me sëmundje
të pashërueshme
Dhe pikëllueshëm e vështronte fluturimin e dallëndysheve,
Dallëndysheve të lumtura, dallëndysheve të gëzueshme...
- "Vallë, a do ta presë kthimin e tyre, kur sërish
do të vij pranvera?"...

Hösten

På sjukhusets balkong satt pojken med en obotlig sjukdom
Och sorgsen såg han svalornas flykt,
Lyckliga svalor, glada svalor...

- "Jag undrar, kommer jag att kunna uppleva deras återkomst,
när våren är här på nytt"?

PA TITULL

Shikoj yjet dhe e di që kurrë s'do mund t'i prekë

- Sa të pamundshëm jemi ndaj gjithësisë

Po, vallë, sa të tjerë, të panumërt, kanë vdekë

Sikurse thonë: - "Pa e kaluar, madje, as pragun e shtëpisë"!?

UTAN TITEL

Jag tittar på stjärnorna och vet att jag aldrig kommer
att kunna röra vid dem

- Så hopplöst har vi det gentemot världsalltet!

Men, undrar jag, hur många är de andra, oräkneligt många,
som har dött som man säger: - "Utan att ens stiga över
husets tröskel"!?

MEHMET BOBI

TË GJITHA I THANË PARA MEJE

Të gjitha i thanë para meje
për dashurinë - për urrejtjen
si mbrohet flamuri
burrat si amshohen

mua asgjë nuk më mbeti
e re deri tek Drita

Edhe sa kohë o zot
ka jetë kjo Ëndërr
mbase pas saj
diç tjetër do të duan njerëzit

Para meje të gjitha i thanë
ke Drita si arrihet

MEHMET BOBI

ALLT SADES FÖRE MIG

Allt sades före mig
om kärleken – om hatet
hur fanan skyddas
och hur män blir saliga

Det fanns inget nytt kvar till mig
fram till Ljuset

Hur länge till, min Gud,
har denna Dröm ett liv
kanske kommer efter den
människorna att önska något annat

Före mig sades allt
Om hur man når fram till Ljuset

DRITA ENDE NUK ZBARDHI

U mplake në dymbëdhjetë ora ime
ndal nuk je, para nuk ecën
fatkeqja ime e kurdisur

Drita ende nuk zbardhi
zot-o! a natë është e gjithë jeta ime?

Njerëzit shëtisin planeteve
me vite drite maten largësitë
Ti sikur nuk di ndryshe
vetëm dymbëdhjetë

LJUSET LYSER INTE ÄN

Du blev gammal vid tolv, min klocka
du har inte stannat, men du går inte
du mitt uppskruvade olycksöde

Ljuset lyser inte än
O Gud, är hela mitt liv en natt?

Människor vandrar på planeterna
i ljusår mäts avstånden
Du tycks inte veta något annat
än att visa tolvslaget

ORA

**Vetëm maestro ia di fillin
të tjerët i habiten fundit
dhe e flakin pastaj
sikur të mos kishte ekzistuar kurrë**

KLOCKAN

Endast maestro känner till början
andra grubblar över slutet
och sedan kastar de den

MAZLLUM SANEJA

VDES PËR TY

Vdes për ty
i tha skamnor i njeriut
që gjithashtu ishte skamnor

Qëndronin përballë njëri-tjetrit
me sy lutës të kryqëzuar
Ndodhi ajo që u desh
fillimi i pruar dhe fundi i tunxhit
Kam fëmijë – pëshpëriti skamnor
edhe unë kam vetem Zotin
Këtë nuk arriti dot ta thotë
E shtynë me forcë në qeli të vdekjes
Maksimilian Kolbin *
dhe krimbi e pyeti për mëkatet
O shenjtëri
te çuditshme janë viset e lindjes tënde

*Maksimiliani ishte prift katolik që u burgos nga nazistët gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ky pranoi të pushkatohej në vend të një izraeliti (shënim i përkthyesit!).

MAZLLUM SANEJA

JAG DÖR I DITT STÄLLE

Jag dör i ditt ställe
sa den eländige till mannen
som också var eländig

De satt mitt emot varandra
med bedjande, korsfästa ögon
Det som måste ske, det hände
början var förhoppning och slutet fördärv

Jag har barn – viskade den eländige
Jag har också bara Gud
Detta hann han inte säga rakt ut
De slängde honom in i dödscellen, Maximilian Kolbe*
och masken frågade honom om hans synder
O helgon
underliga är de trakter som sett er födas

*Maximilian Kolbe var en katolsk präst som fängslades av nazisterna under Andra världskriget. Han erbjöd sig att ersätta en jude som skulle avrättas och gick själv i döden. Helgonförklarad. [Ö.a.]

GJËRA TË MALLKUARA, TË SHKËPUTURA

Vetem Zoti
mund të kuptoje
skëterren e mendimeve
Derisa unë
i dërrmuar
provova
Tani lus me ngulm
kokrrën e rërës
fije barin
trëndafilin
dhe manaferrën për ndjesë

FÖRDÖMDA, LÖSRYCKTA TING

Endast Gud
kan förstå
tankarnas helvete
Medan jag
nedbruten
försökte

Nu ber jag ihärdigt
Sandkornen
Grässtrået
Rosen
och björnbärsbusken om förlåtelse

TË USHQESH KORBAT

Pleqëri
tashmë nuk shkëlqen
me forcë gjallëruese
I kredhur ne mendime
e ndjen veten të vetmuar
Dhe etja e madhe
që Dikush
t'i pëlqej mendimet tua
Me shallin e trashë
mbulon
rininë tënde
të shkujdesur
Prapa dritares
dimër
Duhet edhe ca
të ushqesh korbat

ATT UTFODRA KORPAR

Ålderdom
nu strålar du inte längre
av livgivande kraft
Fördjupad i dina tankar
känner du dig övergiven
Och den stora törsten
att Någon ska
tycka om dina tankar
Med den tjocka schalen
täcker du
din bekymmerslösa
ungdom
Bortom fönstret
vintern
Det krävs lite till
för att utfodra korpar

Një vështrim i shkurtër historik mbi Gjakovën

Kjo trevë që nga antika ka qenë e banuar me dardanët, fis Ilir. Ilir-ia, Albania janë emra të lashtë të popullit dhe vendit tonë indoevropian. Kufinj të natyrorë të Ilirëve e Albanëve janë këta: në jug-perëndim të Ballkanit, pranë Detit Adriatik dhe detit Jon e deri te lumi Sava, në Kroacinë e sotme; Morava, në Serbinë e Sotme; Vardari, në Maqedoninë e sotme si dhe në Greqinë Veriore. Disa shekuj më vonë, duke filluar që nga shekulli i 7-të kur u dyndën Sllavët në Ballkan, trojet tona u zvogëluan për së tepërmi. Pas një kohe, pikërisht në fillim të shekullit 14, Turqia i pushtoi tokat tona dhe për afro 450 vite shqiptarët ngelën nën sundimin turk. Shqiptarët nuk patën të drejtë të shkollohen fare në gjuhën amtare.

Për herë të parë Gjakova përmendet me këtë emër më 1348. Ky emër përbëhet nga dy fjalë: Jak dhe Ova dmth. Fusha e Jakut. Jak e Nikë Vula, vëllezër, ishin shqiptarë të njohur për trimëri dhe u vendosën në këtë qytet nga pushteti okupues turk për ta ruajtur rendin e qetësinë. Pasardhësit e familjes së Jak e Nikë Vulës sot janë me mijëra dhe jetojnë në Gjakovë, si dhe në qytetet tjera të Kosovës e Shqipërisë.

Me shkatërrimin e Perandorisë së Turqisë, pikërisht më 1912, gjysma e tokave shqiptare u pushtua nga shtetet fqinje. Serbia, e cila e mori Kosovën, dhe Maqedoninë e sotme Perëndimore; Mali i Zi e mori Ulqinin Tivarin, Plavën, Gusinë; Greqia e mori Çamërinë. Shqipëria u shpall shtet i pavarur po këtë vit, por ky shtet ishte i gjymtuar keqas, sepse fushat më pjellore, si dhe qytetet më të njohura u grabitën nga shtetet fqinje. Në këtë mënyrë Gjakova u sakatos fare. Pothuajse gjysma e fshatrave të këtij qyteti tashmë nuk mund t'i shisnin prodhimet e tyre në qytet, sepse Serbia kish vënë një kufi të egër që e ndalonte plotësisht qarkullimin e lirë ndërkuftar.

Lartësia mbidetare e Gjakovës është 365 metra, ndërkaq qyteti i ka 586 km², së bashku me 84 fshatra. Janë dy lumenj që rrjedhin në këtë qytet: Ereniku dhe Krena. Në Perëndim të qytetit gjendet kodra e Çabratit, e cila ka qenë prapë frymëzim për poetët e këngëtarët. Në shekullin 16, 17, 18, Gjakova ka pasur zejtarë të llojllojshëm. Këta kanë qenë të njohur në mbarë Kosovën, Shqipërinë, po dhe më gjerë. I tërë qyteti me rrethinë sot i ka 160.000 mijë banorë, kurse vetëm brenda në Gjakovë jetojnë afro 70 mijë. Të gjithë janë shqiptarë.

Në këtë qytet policia e ushtria serbe i ka bërë krimet më makabre, që nga 1912 e deri më më 1999, kur fal luftës së UÇK-ës dhe NATO-s Kosova u çlirua nga Serbia përfundimisht. Vetëm gjatë kësaj lufte, më 1997-1999, në Gjakovë janë vrarë e masakruar nga ushtria e policia e Serbisë mbi 1245 qytetarë, janë

djegur mbi 6.500 shtëpi. Ndërkaq as sot nuk po gjenden eshtrat e të 75 të zhdukurve.

Deri më 1989, kur Serbia e hoqi me dhunë autonominë e Kosovës, Gjakova i kishte disa fabrika me 24 mijë të punësuar. Ndërkaq, sot nga këto fabrika nuk ka mbetur thuajse asgjë. Tani të punësuar janë afro 10.000 në administratë, arsim, në shëndetësi dhe në disa minifabrika e zejtari. Papunësia e të rinjve është afro 70%. Mirëpo, pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, më 17. 02. 2008, ka shpresa se do të thithen investime nga BE e vendet tjera perëndimore dhe do hapen vende të reja pune. Në qytet janë 40 shkolla fillore me 23.500 nxënës, 6 shkolla të mesme, Fakulteti i Edukimit me 800 studentë. Në të gjitha këto mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, por edhe anglisht. Në Gjakovë punojnë 5 Radiostacione si dhe një TV Lokale.

Në Treleborg jetojnë 9 familjeve nga Gjakova e rrethina e saj, por ka edhe shumë familje tjera gjakovare, që banojnë në Landskronë, Malme si dhe në vende të tjera, anembanë Suedisë. Madje, dy pasardhës të familjes më të vjetër gjakovare, Vula, banojnë në Landskronë, Suedi që nga vitet e 90-ta.

Sot pothuajse të gjithë shqiptarët janë të punësuar, kurse fëmijët e tyre i ndjekin mësimet suedisht, ndërkaq si gjuhë amtare e mësojnë edhe gjuhën shqipe. Në Suedi sot banojnë afro 50 mijë shqiptarë. Shumica të ikur nga Kosova në vitet e 90-ta, vite kur Millosheviqi ushtronte terror të paparë ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Është rasti i volitshëm që ta shprehim mirënjohjen tonë më të thellë ndaj shtetit dhe popullit të Suedisë për dhënien e azilit në kohërat më të vështira për kombin tonë si dhe për njohjen e Pavarësisë së Kosovës që në ditët e para të shpalljes së saj. Në emër të të gjithë shqiptarëve që banojnë në këtë vend të mrekullueshëm ne e themi me gojë plot dhe me ton tenori - Faleminderit Suedi!

Redaksia e Revistës "Drita" Treleborg, Suedi, më 20.12.2009

Gjakova - kort historisk återblick

Från antiken har detta område varit bebott av dardanerna, släkte till illyrierna. Namnet Illyrier och Albaner, är ett urgammalt namn på vårt indoeuropeiska folk. De levde i det sydvästra balkanområdet, från Adriatiska havet och Joniska havet till floden Sava, nuvarande Kroatien; Morava, nuvarande Serbien; Vardar, nuvarande Makedonien samt vid Norra Grekland. Senare, under 700-talet, började folkvandringen av de slaviska folken till Balkan. Detta medförde att stora delar av våra områden förlorades. Efter en tid, i början av 1400-talet ockuperade Turkiet våra områden och albanerna tvingades att leva under turkiskt styre i 450 år. Under denna tid fick inte albanerna undervisas i sitt eget språk.

Den första gången som namnet Gjakova användes var år 1348. Detta namn är sammansatt av två ord: Jak och Ova, vilket betyder Jakuts slätter. Jak och Nikë Vula, var två albanska bröder som var kända för sin modighet. De bosatte sig i denna stad, som var ockuperad av turkarna, för att bevara lugn och ro. Kommande generationer efter familjen Jak och Nikë Vula, har medfört att det idag lever tusentals av dessa i Gjakova, samt även i andra städer i Kosova.

Efter det Ottomanska rikets fall under 1912, blev hälften av de albanska områdena ockuperade av grannländerna. Serbien tog Kosova och västra delen av dagens Makedonien. Montenegro tog Ulcin, Tivari, Plaven och Gusine, samt Grekland tog Çamërinë. Under detta år blev Albanien självständigt, men det blev en dålig utgångspunkt för nationen, eftersom de bördiga slätterna och de mest kända städerna, blev erövrade av grannländerna. I och med detta blev Gjakova mycket fördärvat. Man kan säga att hälften av böndernas produktion av spannmål runt omkring Gjakova, inte kunde säljas till stadens invånare, för Serbien hade upprättat en gräns där man utförde grymheter och därmed fick invånarna begränsad rörelsefrihet.

Gjakova är beläget 365 meter över havet och staden har en yta av 586 kvadrat km. med 84 byar inkluderade. Två floder rinner genom staden: Ereniku och Krena. I västra delen av staden ligger berget Çabrati, som har givit inspiration till poeter och musikanter. Under 1600, 1700 och 1800-talet har Gjakova haft många hantverkare inom olika yrken. Dessa var mycket kända i Kosova, Albanien och angränsande områden. Idag har Gjakovas kommun 160 000 invånare, medan själva staden har ca.70 000 invånare. Alla är albaner.

I den här staden har den serbiska polisen och armen utfört grymma handlingar mot befolkningen, från 1912 till och med 1999, då Kosova tack

vare UÇK och NATOs hjälp till slut blev självständigt från Serbien. Under kriget 1997-1999 blev 1245 invånare i Gjakova skjutna och lemlästade av den serbiska armén och polisen. Över 6 500 hus blev nerbrända. Än idag har man inte kunnat hitta kvarlevorna efter 75 döda människor.

Till och med året 1989 när Serbien med våld frantog Kosovos autonomi, fanns det i Gjakova några fabriker med 24 000 anställda. Idag finns det inget kvar av dessa. Nu är nästan 10 000 anställda i administration, undervisning, sjukvård och i några små företag som hantverkare. Arbetslösheten bland ungdomar är ca 70%. Efter Kosovos självständighet den 17. 02. 2008, finns förhoppningar om investeringar av EU och andra Europeiska länder, så att sysselsättningen kommer att öka igen. Det finns 40 grundskolor med 23 500 elever, 6 gymnasieskolor och en högskola med 800 lärarstudenter. I alla dessa skolor undervisas eleverna i albanska och engelska språket. I Gjakova finns 5 radiostationer och en TV-station.

I Trelleborg finns 9 familjer från Gjakova. Andra familjer från Gjakova bor i Landskrona, Malmö och andra städer i övriga Sverige. Ättlingar till den äldsta släkten från Gjakova, är familjen Vula. Två familjer av Vulasläkten är bosatta i Landskrona sedan 1990.

Idag kan man säga att nästan alla albaner i Sverige har en anställning. Deras barn lär sig svenska samtidigt som de också undervisas i sitt hemspråk albanska. I Sverige bor idag ca 50 000 albaner. De flesta flydde från Kosova under 1990-talet. Det var under denna tid då Milosevic använde den grymmaste terrorn och våldet mot albanerna i Kosova.

Nu är det ett lämpligt tillfälle för det albanska folket att tacka den svenska regeringen och det svenska folket för deras stöd när de gav albanerna asyl under denna svåra tid, samt för erkännandet av Kosovos självständighet, redan under de första dagarna. Från alla albaner som är bosatta i det underbara landet, säger vi från vårt hjärta, samt med rösten från en tenor - Tack Sverige!

Styrelsen i Tidskriften "Drita" Trelleborg, Sverige, den 20.12.2009

POETËT NGA GJAKOVA - NË SUEDISHT

POETERNA FRÅN GJAKOVA - PÅ SVENSKA

ZGJODHI

I URVAL AV

S H E F I O S E K U

PËRKTHEU

ÖVERSÄTTNING AV

**ULMAR KVIKU
HAJDIN ABAZI**

Libri u botua me ndihmen e ABF-it, në Treleborg, Suedi

Boken utgiven med hjälp av ABF, i Trelleborg, Sverige

BOTIM I REVISTËS "DRITA", NË TRELEBORG, SUEDI

UTGIVEN AV TIDSKRIFTEN DRITA, I TRELLEBORG, SVERIGE

•

POETËT NGA GJAKOVA - NË SUEDISHT

POETERNA FRÅN GJAKOVA - PÅ SVENSKA

ZGJODHI

I URVAL AV

S H E F K I O S E K U

KORREKTORË

për poezitë në gjuhën shqipe si dhe tekstet tjera

KORREKTURLÄSARE, för albanska dikter och andra texter

Shefki Oseku

Ulmar Kvik

Agim Mazari

Kompjuterizimi

Dataansvarig

Frashër Oseku

Libri u botua me ndihmën e ABF-it, në Treleborg, Suedi

Boken är tryckt med hjälp av ABF i Trelleborg, Sverige

U dorëzua në shtyp në janar të vitit 2010

Till tryckning januari 2010

BOTIM I REVISTËS "DRITA" NË TRELEBORG, SUEDI
UTGIVEN AV TIDSKRIFTEN DRITA, i TRELLEBORG, SVERIGE

TIRAZHI 1000 copë

UPPLAGA 1000 ex.

PËRMBAJTJA – INNEHÅLLET

BESIM BOKSHI.....	
XAJË NURA.....	
AGIM GJAKOVA.....	
DIN MEHMETI.....	
ALI PODRIMJA.....	
KADRUSH RADOGOSHI.....	
SHEFKI OSEKU.....	
ESAT ÇËRMJANI.....	
MEHMET BOBI.....	
MAZLLUM SANEJA.....	
Një vështrim i shkurtër historik mbi Gjakovën.....	
Gjakova - en kort historisk återblick.....	